



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PEQIN
NJËSIA E PROKURIMIT

Peqin, më 18/06/2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: *Blerje materiale per rebailitimin e Kroit te qytetit, Bashkia Peqin*

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
materiale ndertimi dhe produkte te ngjashme : **44100000-1**

VLERA E FONDIT LIMIT : 4.259,915 (katërmiljon e dyqind e pesëdhjet e e nente mije e nentëqind e pesëmbëdhjetë) Leke pa TVSH. nga buxheti i Bashkisë Peqin për nevoja të Bashkisë Peqin, për vitin 2026;

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Peqin ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3, në masën 2% të vlerës së përllogaritur të kontratës në një nga format e parashikuara në ligjin nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” konform nenit 83, përkatësisht në vlerën prej 167,400 (njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind) lekë ;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Kapacitetin profesional/ligjor të operatorëve ekonomikë:

a. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën e cilesise se shërbimit **ISO 9001- 2015 OSE EKVIVALENTE** (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes).

Argumentimi tekniko-ligjor i kësaj kërkesë qëndron në faktin se objekti i prokurimit përfshin furnizim me produkte me karakteristika teknike të ndryshme, si materiale ndërtimore, elemente dekorative, komponentë urbanë, materiale ndriçimi dhe produkte të tjerë që duhet të plotësojnë standarde të qëndrueshme cilësie, uniformiteti prodhimi, kontrolli procesi, gjurmueshmëri dhe menaxhimi operacional. ISO 9001 provon se operatori ekonomik funksionon sipas një sistemi të strukturuar të menaxhimit të cilësisë, që minimizon riskun e furnizimit me produkte jokonforme, rrit sigurinë mbi qëndrueshmërinë e parametrave teknikë të produktit dhe garanton ekzistencën e mekanizmave të brendshëm për kontrollin, korrigjimin dhe përmirësimin e proceseve. Përdorimi i formulimit “ose ekuivalente” siguron respektimin e parimit të mosdiskriminimit, ruan konkurrencën efektive dhe shmang çdo risk interpretimi kufizues ose favorizues për subjekte të caktuara ekonomike

b. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën e **ISO 14001: 2015 OSE EKVIVALENTE** me të, lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit. *vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë*. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes).

Argumentimi: Duke qenë se objekti i prokurimit lidhet drejtpërdrejt me sistemin mjedisor, mobilim urban, ndriçim, materiale ndërtimore dhe elemente të gjelbërimit, është teknikisht e arsyeshme që operatori ekonomik të provojë se ushtron aktivitet sipas praktikave të kontrolluara të menaxhimit mjedisor. ISO 14001 provon ekzistencën e procedurave të kontrollit të ndikimit ambiental, përdorimit racional të burimeve, menaxhimit të mbetjeve, parandalimit të ndotjes dhe përputhshmërisë me standardet mjedisore. Kjo jo vetëm që rrit sigurinë juridike dhe cilësinë e kontratës, por harmonizohet me parimet moderne të prokurimit publik të qëndrueshëm. Edhe këtu formulimi “ose ekuivalente” ruan konkurrencën dhe garanton neutralitet procedural.

Ky kriter plotësohet me dorëzimin e Certifikatave.

Argumentimi: *Certifikatat e kërkuara duhet të jenë të vlefshme ne kohen e zhvillimit te procedures së prokurimit. Certifikatat e mësipërme duhet të jenë në gjuhën shqip ose të jenë të përkthyer në shqip, si dhe origjinale ose të njehsuara me origjinalin (kopje të noterizuar). Certifikatat duhet të jenë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Ne rastet kur oferta dorezohet nga nje BO, operatorët duhet te disponojne certifikatat e kerkuara në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023,2024,2025. Vertetim per xhiron vjetore te tre viteve te fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës** te procedures se prokurimit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo me e vogel por pa tejkaluar vleren maksimale 40% te vleres se fondit limit, të kontrates qe prokurohet

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros se percaktuar dhe te kerkuar nga autoriteti kontraktor kerkohet për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike te operatorit ekonomik si dhe per të vendosur kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne legjislacioni tatimor ku xhiroja dhe bilancet kane si afat perfundimtar per tu mbyllur dhe dorezuar prane organeve tatimore maksimumi deri ne fund te muajit Prill te vitit qe vjen.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar sipas ligjit nr.8438 date 28.12.1998 i ndryshuar. (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare 2023, 2024, 2025, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41/c të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, \\ese kërkohej bilance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht: Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në legjislacionin tatimor ku xhiroja dhe bilancet kanë si afat përfundimtar për tu mbyllur dhe dorëzuar pranë organeve tatimore maksimumi deri në fund të muajit Prill të vitit që vjen. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë bazuar sipas ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 i ndryshuar. Shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41/c të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të ketë paguar taksat dhe tarifat vendore për vitin 2025 (këstet e maturuara) për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifat vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP si dhe në ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1-Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e shërbimeve të mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës/lotit që prokurohet .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave

të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve per proceduren e hapur te thjeshtuar eshte përcaktuar se vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Për materialet e ndricimit sipas zerave të punimeve objekt prokurimi, operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog teknik, dhe mostra që provon përputhshmërinë e produktit me specifikimet e kërkuara. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë mostra për artikujt në preveniv, nga një cope. Dorëzimi i mostrave do të bëhet ditën e dorëzimit të dokumentacionit pranë Bashkisë Peqin (për operatorin ekonomik të shpallur fitues) ofertuesi duhet të bejë shoqërimin e mostrave me një shkresë të firmosur nga përfaqësuesi ligjor dhe vulosur ku të listohen mostrat. Mosparaqitja e të gjitha mostrave është kusht skualifikim.

Argumentim teknik i kësaj kërkesë qëndron në nevojën që autoriteti kontraktor të ketë mundësi objektive për të verifikuar karakteristikat reale të mallit të ofertuar, përpara lidhjes së kontratës. Katalogët teknikë dhe dokumentacioni ekuivalent mundësojnë verifikimin e parametrave teknikë, materialeve përbërëse, performancës funksionale, standardeve të prodhimit dhe përputhshmërisë me kërkesat e autoritetit kontraktor. Formulimi është bërë në mënyrë fleksibile, duke lejuar dokumentacion ekuivalent, me qëllim ruajtjen e konkurrencës dhe shmangien e çdo interpretimi kufizues.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim me anë të së cilës garanton furnizimin e mallrave sipas sasive, cilësive dhe parametrave teknikë të kërkuar, si dhe zëvendësimin pa kosto shtesë të çdo malli me defekt, të dëmtuar ose jokonform me specifikimet

teknike. Kjo kërkesë është e lidhur drejtpërdrejt me mbrojtjen e interesit publik, sigurinë juridike të kontratës dhe garantimin e cilësisë së furnizimit.

Argumentimi teknik lidhet me faktin se natyra e mallrave objekt kontrate kërkon që autoriteti kontraktor të ketë siguri të plotë mbi përputhshmërinë reale të produkteve me parametrat e kërkuar dhe mbi ekzistencën e përgjegjësisë kontraktore të operatorit ekonomik në rast mospërputhjeje. Kjo kërkesë është standarde, proporcionale dhe juridikisht e balancuar.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili parashikon se specifikimet teknike duhet të hartohen në mënyrë që të mundësojnë akses të barabartë për operatorët ekonomikë dhe të mos krijojnë pengesa të pajustificuara për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës, si dhe në zbatim të dispozitave përkatëse të VKM nr.285, datë 19.05.2021, Autoriteti Kontraktor ka hartuar specifikimet teknike për mallrat objekt prokurimi mbi bazën e funksionit real publik që këto mallra do të kryejnë, mbi bazën e parametrave minimalë të cilësisë dhe jetëgjatësisë, si dhe mbi nevojën për të siguruar përputhshmëri ndërmjet karakteristikave teknike të produkteve dhe përdorimit afatgjatë të tyre në ambient publik, ku ekspozimi ndaj kushteve atmosferike, konsumit fizik, amortizimit natyror dhe ngarkesës funksionale është më i lartë sesa në përdorim të zakonshëm privat.

Nga pikëpamja teknike, duke qenë se objekti përfshin furnizim me materiale ndërtimore, elemente dekorative urbane, komponentë ndriçimi, materiale me funksion mjedisor dhe elemente të mobilitetit urban, specifikimet janë hartuar mbi tri shtylla themelore:

- (i) rezistenca fizike dhe strukturore;
- (ii) qëndrueshmëria ndaj faktorëve klimatikë dhe mjedisorë;
- (iii) performanca funksionale dhe jetëgjatësia ekonomike e produktit.

Këto tre elemente janë bazë objektive për përcaktimin e kërkesave minimale teknike dhe lidhen drejtpërdrejt me mbrojtjen e interesit publik, me minimizimin e kostove të mirëmbajtjes në të ardhmen dhe me garantimin që fondet publike përdoren për produkte me cilësi të qëndrueshme dhe jo për furnizime me cikël të shkurtër përdorimi apo me risk të lartë zëvendësimi.

TABELË PËRMBLEDHËSE E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE TË MATERIALEVE

Nr.	Kategoria e materialit	Specifikimi teknik minimal	Argumentimi funksional dhe teknik
1	Materiale ndërtimore (çimento, beton, inerte, lidhës ndërtimorë)	Rezistencë mekanike sipas standardeve kombëtare / europiane; qëndrueshmëri ndaj lagështisë; koeficient i përshtatshëm lidhjeje dhe kompaktësie	Garantojnë integritet strukturor, stabilitet fizik dhe jetëgjatësi të elementeve restaurues
2	Gur dekorativ / kalldrëm / bordura	Rezistencë ndaj konsumit, ngricës, lagështisë dhe goditjes; dimensionim uniform; densitet i kontrolluar	Siguron jetëgjatësi, estetikë urbane dhe siguri në qarkullim publik
3	Elementë ndriçimi urban	Efikasitet energjetik; shkallë mbrojtjeje IP e përshtatshme; material antikorroziv; jetëgjatësi funksionale	Garanton siguri elektrike, ulje të kostove operative dhe rezistencë ndaj kushteve atmosferike
4	Panele fotovoltaike / komponentë energjie	Performancë e certifikuar; efikasitet teknik; rezistencë klimatike; komponentë me garanci prodhuesi	Mundëson eficiencë energjetike dhe funksionim afatgjatë me mirëmbajtje të ulët
5	Mobilim urban (stola, elementë dekorativë)	Material rezistent ndaj UV, korrozionit, konsumit fizik dhe lagështisë	Jetëgjatësi e lartë dhe reduktim i kostove të zëvendësimit
6	Materiale gjelbërimi / fidane / substrate	Cilësi biologjike e kontrolluar; përshtatshmëri klimatike; zhvillim i shëndetshëm vegjetativ	Rrit normën e mbijetesës dhe qëndrueshmërinë e investimit mjedisor

KUJDES !Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës

shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Njësia e Prokurimit njëkohësisht Komision për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, për përcaktimin e specifikimeve teknike, etj;